



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. 2033 prot

Shkodër, me datë 05.12.2023

VENDIM
Nr. 20 datë 5.12.2023

Për

“Shpallje konkurrimi për vende të lira pune nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, dhe pranimi në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive

Në mbështetje të nenit 38 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 114,117 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Vendimit nr.622, datë 10.2.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr. 150 datë 29.03.2023 të KLGJ-së “Për Miratimin e Rregullave standarte, për Organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e II dhe e III, me zyra shërbimi”, Vendimit nr. 483 prot, datë 31.03.2019 të Këshilli i Gjykatës pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, “Për detajimin e pozicioneve të punës për punonjësit e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe miratimin e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi”, në vijim edhe të VKM-së nr. 325 datë 31.05.2023, si dhe referuar shkresës nr. 1951 prot, datë 16.11.2023 të kancelares drejtuar KLGJ-së, ku kjo e fundit ka konfirmuar mospatjen e listës pritëse për pozicionet e lira me shkresën nr. 6043/1 prot, datë 22.11.2023 (Nr.1951/1 prot, datë 23.11.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër);

VENDOSI:

- Të shpallë procedurat për lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil si më poshtë :
 1. **2 (dy) pozicione sekretar/e gjyqësor/e**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria ekzekutive IV- 1.
 2. **1 (një) pozicion specialist arkive**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër specialiste arkive”, Sektorit të Kordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll /Arkivë, kategoria ekzekutive IV-2.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të gjykatës, si dhe i komunikohet KLGJ-së dhe çdo gjykatë së bashku me njoftimet për shpallje bashkëlidhur këtij vendimi.

Këshilli i Gjykatës

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër


ANËTARE

Valbona SULEJMANI



ANËTAR

Tonin STERKAJ



KRYETAR

Sokol SHEHU

